



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Nr. Prot. 262/004 Dt 26.02.2018

Në mbështetje të nenit 49 pika 1.3 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", Senati i Universitetit në mbledhjen e mbajtur më 9.2.2018, nxori këtë:

RREGULLORE PËR STUDIMET MASTER NË UNIVERSITETIN E
MITROVICËS "ISA BOLETINI"

Qëllimi

Neni 1

Me Rregulloren për studimet master (në tekstin e mëtejshëm: Rregullore) rregullohet: fushëveprimi, organizimi dhe llojet e studimeve; kriteret dhe procedurat për pranimin dhe regjistrimin e studentëve në studimet master; statusi i studentit-të drejtat dhe detyrimet e studentëve; kushtet e regjistrimit të vitit; ndërrimi i programit-drejtimit të studimeve; kohëzgjatja e studimeve; viti akademik; organizimi i provimeve, vlerësimi i studentëve dhe përfundimi i studimeve.

Fushëveprimi, organizimi dhe llojet e studimeve

Neni 2

1. Me qëllim të përgatitjes së kuadrit për veprimtari profesionale dhe shkencore-kërkimore, Universiteti i Mitrovicës (UMIB), në kuadër të njësisë akademike organizon studime të rregullta të nivelit master (i shkencës ose profesional), për fitimin e gradës akademike master në fushat e përcaktuara në programet e studimit të akredituara nga AKA/KSHC.
2. Studimet master, njësitë akademike të UMIB-it mund t'i organizojnë edhe në kuadër të bashkëpunimit të dy fakulteteve duke ofruar programe dy lëndore të studimeve dhe programe ndërdisiplinare të studimeve dhe në kuadër të bashkëpunimit të UMIB-it dhe universiteteve tjera duke ofruar programe të përbashkëta të studimeve, në bazë të marrëveshjeve apo kontratave për partneritet.
3. Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen në njësitë akademike të UMIB-it.



Neni 3

1. Njësitë akademike, programet e studimit master i organizojnë në kuadër të departamenteve.
2. Studimet master zhvillohen sipas sistemit modular dhe bazohen në lëndë të ngushta të specializimit brenda departamenteve.
3. Sistemi i punës në këtë cikël studimesh përfshinë edhe orët e punës praktike-praktikën kërkimore hulumtuese të cilën duhet ta përfundojnë studentët.
4. Studimet master zgjasin 1 respektivisht 2 vjet dhe kërkojnë 60 respektivisht 120 pikë të ECTS-së.
5. Përfundimi me sukses i studimeve bachelor është kusht për regjistrimin e studimeve master.
6. Me përfundimin e suksesshëm të studimeve master fitohet grada master i shkencave apo master profesional.

Neni 4

1. Të drejtën e dhënies së mësimin në studimet master e ka personeli akademik në thirrje të profesorit (profesor i rregullt, profesor i asocuar dhe profesor asistent). Të drejtën e mbajtjes së ushtrimeve në këtë cikël studimesh e kanë asistentët të cilët kanë së paku gradën e masterit.
2. Në raste të caktuara në një lëndë, mësimin, mund ta mbajnë dy apo më shumë mësimdhënës. Në rastin kur mësimin e mbajnë më shumë mësimdhënës, njëri nga mësimdhënësit është bartës i lëndës.

Neni 5

Mësimi realizohet në formë të ligjëratave, seminareve, ushtrimeve teorike, ushtrimeve në laborator, punës praktike dhe punës në teren, ekskursioneve profesionale, diskutimeve, konsultimeve profesionale dhe nëpërmes punimeve të pavarura të studentëve.

Kriteret dhe procedurat për pranimin dhe regjistrimin e studentëve

Neni 6

Përmbajtja e njoftimit për konkurs

1. Senati i UMIB-it, bazuar në propozimin e njërive akademike dhe në pajtim me vendimin e AKA/KSHC për akreditim të programeve, shpall konkurs për pranimin e studentëve, pas miratimit nga MASHT-i.
2. Njoftimi për konkurs duhet të përfshijë:
 - 2.1. Numrin e përgjithshëm të studentëve që pranohen dhe kuotat nga komuniteti jo shumicë;
 - 2.2. Kriteret për konkurrim;

- 2.3. Dokumentet e nevojshme për aplikim dhe regjistrim;
- 2.4. Mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve;
- 2.5. Shpallja e rezultateve të konkursit;
- 2.6. Afatet për secilën fazë të konkursit;
- 2.7. Të drejtën e ankesës;
- 2.8. Numri i studentëve për regjistrim sipas njësive akademike dhe programeve të studimit.

Kriteret për konkurrim

Neni 7

1. Në studimet master në UMIB, mund të pranohen kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet bachelor apo studimet themelore para hyrjes në fuqi të Deklaratës së Bolonjës në të gjitha institucionet e Arsimit të Lartë në Kosovë. Në kushte të barabarta, përparësi në pranim do të kenë kandidatët të cilët i kanë mbaruar studimet themelore-bachelor në UMIB.
2. Të drejtë pranimi në UMIB kanë edhe të gjithë kandidatët tjerë të cilët i kanë përfunduar me sukses studimet bachelor apo themelore jashtë Kosovës. Në raste të tilla, kandidati duhet të sjellë dëshminë (vërtetim apo vendim) mbi akreditimin e institucionit në të cilin i ka mbaruar studimet paraprake. Në pamundësi të sigurimit të dëshmisë për akreditim, atëherë statusi i këtyre programeve do të konfirmohet nga zyra për zhvillim akademik e UMIB-it. Vendimi për njohjen dhe për barasvlerën e diplomës, të fituar jashtë Kosovës, merret nga MASHT-i, ndërsa barasvlera e notave do të bëhet nga zyra për zhvillim akademik e UMIB-it.
3. Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet paraprake në një program studimi, mund të konkurrojnë për pranim në studimet master në një program tjetër. Në rast pranimi, Këshilli i njësisë akademike, në propozim të Komisionit të Studimeve, mund të caktojë provime diferenciale të cilave duhet t'iu nënshtrohen paraprakisht kandidatët. Numri i provimeve caktohet varësisht nga shkalla e krahasueshmërisë/ngjashmërisë së programit të ndjekur në studimet paraprake të kandidatit. Në raste të tilla, kandidatët ndjekin ligjëratat në vitin vijues akademik dhe iu nënshtrohen provimeve në afatin e janarit, prillit, qershorit dhe shtatorit. Kandidatët do të kenë më së shumti deri në pesë provime diferenciale të cilave do t'iu nënshtrohen para komisionit prej tre anëtarësh ndërsa procesverbalet e provimeve të tilla ratifikohen nga këshilli i njësisë akademike përkatëse.
4. Përjashtim nga paragrafi 3 i këtij neni bëhet për programet studimore me specifika të veçanta, të cilat i përcaktojnë vetë njësitet akademike.

5. Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilindo nivel të studimit në kuadër të UMIB-it, nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi në UMIB, pa përfunduar studimet në programin ku janë duke vijuar studimet ose pa u çregjistruar nga programi aktual i studimeve.
6. Kandidatët për pranim si student të UMIB-it në vitin përkatës akademik nuk mund të konkurrojnë më shumë se në një fakultet apo program.

Neni 8

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim dhe regjistrim

1. Aplikimi për pranim në studime bëhet online nëpërmes SEMS-it (Sistemi i Menaxhimit Elektronik të Studentëve).
2. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim, në njësitë akademike të UMIB-it, është:
 - 2.1. Certifikata apo ekstrakti i lindjes (origjinal);
 - 2.2. Kopja e letërnjoftimit;
 - 2.3. Diploma-certifikata e diplomimit origjinal e studimeve themelore-bachelor, ose kopja e noterizuar sipas origjinalit;
 - 2.4. Dëshmia e akreditimit të institucionit të arsimit të lartë (për kandidatët që kanë mbaruar studimet jashtë vendit dhe në kolegjet private të Republikës së Kosovës);
 - 2.5. Pasqyra e provimeve të dhëna me notë mesatare, (vetëm për kandidatët nga programe dhe fakultete të tjera);
 - 2.6. Fletëparaqitja e plotësuar shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: www.umib.net;
 - 2.7. Pagesa për aplikim në lartësi të përcaktuar sipas UA të MASHT-it. (Forma e pagesës shkarkohet nga ueb-faqja e UMIB-it);
 - 2.8. Vendimi mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit.
3. Dokumenti nën pikën 2.3. mund të pranohet duplikat vetëm nëse dëshmohet me vërtetim të organeve kompetente për humbje, dëmtim, vjedhje etj.

Neni 9

Mënyra e përzgjedhjes së kandidatëve

1. Përzgjedhja e kandidatëve për pranim në studimet master deri në numrin e përcaktuar sipas konkursit bëhet sipas ranglistës prioritare të notës mesatare të arritur gjatë studimeve 7.50 e më lartë.

2. Në rastin kur numri i kandidatëve është më i vogël se numri i paraparë me konkurs, atëherë mund të pranohen edhe kandidatë me notë mesatare më të ulët se 7.50, por ata do t'i nënshtrohen provimit pranues. Rangimi i kandidatëve në këtë rast bëhet në bazë të:
 - 2.1. Notës mesatare gjatë studimeve dhe
 - 2.2. Rezultateve të provimit pranues.
3. Provimi pranues organizohet nga fakultetet dhe mbahet nga lëndët të cilat i përcaktojnë vetë fakultetet, por jo më shumë se tri lëndë. Numri maksimal i pikëve të arritura në provimin pranues është 100. Kriteret dhe kushtet e provimit pranues i përcaktojnë fakultetet.
4. Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve, të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve, është i barabartë, zgjedhja e kandidatëve deri në numrin e planifikuar për pranim, do të bëhet në bazë të suksesit të përgjithshëm në studimet themelore-bachelor. Nëse edhe pas kësaj do të kemi rezultat të njëjtë, atëherë përparësi do të kenë kandidatet e gjinisë femërore. Në rastin kur organizohet provimi pranues përparësia e studentëve fillon nga numri i pikëve të fituara në provimin pranues, pastaj suksesit të përgjithshëm në studimet themelore-bachelor dhe në fund përparësi do të kenë kandidatet e gjinisë femërore. Nëse edhe pas këtij kriteri numri i pikëve mbetet i barabartë atëherë zgjedhjen e kandidatëve do ta bëjë komisioni përkatës i fakultetit.
5. Fakultetet janë të obliguara që tërë listën e kandidatëve, të cilët kanë konkurruar, t'ia dërgojnë Rektoratit dhe ta publikojnë në ueb-faqen e UMIB-it.
6. Përzgjedhjen e kandidatëve e bënë Komisioni për pranimin e studentëve.
 - 6.1. Komisioni për pranimin e studentëve formohet nga Këshilli në nivel të njësisë akademike dhe përbëhet prej tre ose pesë anëtarëve;
 - 6.2. Mandati i Komisionit përfundon pas përfundimit të procesit të pranimit të studentëve.

Neni 10

Procedurat lidhur me organizimin dhe mbajtjen e provimit pranues

1. Njësitë akademike e organizojnë mbajtjen e provimit pranues më së shumti në tri lëndë mësimore, të cilat i caktojnë vetë fakultetet.
2. Testi me shkrim për provimin pranues, për secilin program të studimeve, përgatitet nga komisioni për hartimin e testeve me shkrim. Komisioni për hartimin e testit me shkrim përbëhet prej tre anëtarëve nga radhët e personelit akademik dhe formohet nga këshilli i njësisë akademike.

Neni 11

Shpallja e rezultateve të konkursit

1. Në programin përkatës të studimeve pranohen kandidatët të cilët kanë arritur numrin më të madh të përgjithshëm të pikëve konform radhitjes në listën përfundimtare, deri në plotësimin e numrit të studentëve që pranohen në programin e studimeve.
2. Rezultatet e provimit pranues dhe të pikëve të përgjithshme të fituara nga kandidatët sipas të gjitha kriterëve shpallen në tabelën e shpalljeve dhe në ueb faqen zyrtare të Universitetit.

Neni 12

E drejta e ankesës

1. Kandidatët të cilët nuk janë pranuar në vitin e parë të studimeve master mund të ankohen kundër vendimit brenda tri ditëve të punës pas shpalljes së rezultateve të përzgjedhjes. Ankesat i drejtohen komisionit për pranimin e studentëve.
2. Vendimi përfundimtar rreth ankesës merret nga komisioni 3 anëtarësh, kryesuar nga prorektori për mësim dhe çështje të studentëve dhe me anëtarë të tjerë të emëruar nga rektori.

Neni 13

Regjistrimi i studentëve

1. Regjistrimi i studentëve të pranuar në vitin e parë bëhet në Administratën Qendrore të Universitetit dhe në njësinë akademike ku është pranuar studenti, sipas orarit të përcaktuar me konkurs.
2. Kandidatët e pranuar në studime, me rastin e regjistrimit, do të dorëzojnë:
 - 2.1. Fletëregjistrimin e plotësuar, i cili merret me rastin e regjistrimit;
 - 2.2. Dy fotografi (formati 4.5 x 6 cm), të cilat duhet të jenë sipas normave dhe rregullave për dokumente personale.
3. Pagesa për semestër bëhet në lartësi të përcaktuar me UA të MASHT-it, lidhur me pagesat, e cila shkarkohet dhe shtypet nga ueb faqja e Universitetit të Mitrovicës.
4. Studentit të regjistruar në studime i lëshohet ID e studentit.

Statusi i studentit

Neni 14

1. Personi i regjistruar në njësitë akademike të Universitetit të Mitrovicës e ka statusin e studentit.
2. Statusi i studentit dëshmohet me ID të studentit.

3. Me lejen e dekanit të fakultetit studentit mund t'i jepet "ID duplikat", nëse dëshmohet me vërtetim të organeve kompetente për humbje, dëmtim, vjedhje etj.

Neni 15

1. Studenti e humb statusin e studentit:

1.1. Kur vendos t'i ndërprejë studimet;

1.2. Kur i ka përfunduar studimet;

1.3. Kur dështon të regjistrohet në vitin akademik;

1.4. Kur nuk i ka përfunduar studimet në periudhën e dyfishit të kohëzgjatjes së studimeve;

1.5. Kur arrin numrin maksimal të regjistrimit të serishëm të viteve pa i përfunduar me sukses studimet;

1.6. Në rastin e përjashtimit, në bazë të vendimit të nxjerrë pas procedurës disiplinore.

2. Studenti mund të kërkojë një herë që t'i vazhdohet kohëzgjatja e studimeve për një apo dy vite. Vendimin e merr këshilli i njësisë akademike. Në rast se merret vendim pozitiv, studenti do ta ketë sërish statusin e studentit të rregullt.

3. Këshilli i njësisë akademike zbaton rregullat e posaçme për mbajtjen e statusit të studentit të rregullt në këto raste:

3.1. Për të arriturat e veçanta në fushën e sportit, vërtetuar me status amator apo profesional në nivel rajonal apo më lart;

3.2. Për të arriturat e veçanta si krijues artistik i njohur, vërtetuar me reagimin relevant të medieeve;

3.3. Për individët me aftësi të kufizuara fizike, duke përfshirë edhe aftësitë e kufizuara të të parit dhe të dëgjuarit, apo intelektuale, vërtetuar me certifikatë të mjekut. Vendimi për regjistrim merret për çdo vit nga këshilli i njësisë akademike. Këta studentë duhet të jenë të pajisur me pajisje të veçanta që i përgjigjen nevojave të tyre dhe ju mundësojnë ndjekjen e studimeve, duke paraparë edhe formën e veçantë të provimit.

4. Studenti mund të kërkojë suspendim të përkohshëm nga statusi i studentit të rregullt në rastet e dëshmuara si të:

4.1. Sëmundjes së rëndë;

4.2. Kujdesi për fëmijët nën moshën tri vjeçare;

4.3. Shtatzënisë dhe lehonisë;

4.4. Të tjera të justifikuara. Vendimin përfundimtar e merr dekani i njësisë akademike.

Neni 16

1. Statusi i studentit të rregullt mbahet brenda dy viteve pasi të kenë përfunduar të gjitha provimet. Gjatë kësaj kohe studentit duhet të japë provimin e diplomës që t'i përfundojë me sukses studimet.
2. Studenti që e ka tejkaluar kohën e paraparë për të përfunduar me sukses diplomën mund të paraqesë kërkesë te dekani i njësisë akademike për zgjatjen e kësaj periudhe vetëm edhe për një vit.

Neni 17

1. Studenti mund të regjistrohet sërish si student i rregullt pa ndonjë pengesë në lidhje me periudhën e suspendimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt. Periudha e suspendimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt nuk llogaritet në kohëzgjatje e studimeve.
2. Në qoftë se planprogrami valid në kohën e regjistrimit të parë të studentit nuk zhvillohet në vitin vijues të regjistrimit të studentit pas suspendimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt, komisioni i studimeve i njësisë akademike vendos për provimet diferenciale ose për obligimet tjera shtesë si kusht për vazhdimin e studimeve.

Të drejtat dhe detyrimet e studentëve

Neni 18

1. Studentët kanë këto të drejta:
 - 1.1. Të marrin pjesë në ligjërata, seminare, ushtrime teorike, ushtrime në laborator, punë praktike dhe punë në teren, ekskursionet profesionale dhe shkencore-mësimore, diskutime, konsultime profesionale dhe forma tjera të mësimit sipas plan programeve në fuqi;
 - 1.2. Të shfrytëzojnë Bibliotekën Universitare dhe të njësisë akademike dhe shërbimet tjera për studentë;
 - 1.3. Të marrin pjesë në zgjedhjet për përfaqësuesit studentë në organet universitare dhe të fakultetit, të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e organeve dhe të komisioneve ku janë të caktuar si anëtarë dhe t'i kryejnë detyrat e tilla me angazhim dhe në mënyrë të sqartë. Në rast të konfliktit të interesit në lidhje me përmbajtjen, anëtarët e deleguar të studentëve nuk marrin pjesë në takime të organeve qeverisëse të fakultetit;
 - 1.4. Të përfitojnë bursa studimi dhe shpërblime të veçanta që administrohen nga UMIB-i, kur i plotësojnë kushtet e përcaktuara nga organi i universitetit;
 - 1.5. Studentët gëzojnë të drejtën për të paraqitur ide të reja dhe opinione të debatueshme pa rrezikuar humbjen e vendit të studentit ose privilegjet që mund të gëzojnë nga UMIB-i;

- 1.6. Studentët kanë të drejtë të ankohen lidhur me cilësinë e procesit të mësimdhënies ose për infrastrukturën e UMIB-it;
- 1.7. Studentët gëzojnë të drejtën për të kundërshtuar një vendim apo një veprim të UMIB-it ndaj tyre në Ministri dhe në gjykatën kompetente.
2. Studentët kanë këto detyrime:
 - 2.1. T'i respektojnë rregulloret e lëshuara nga UMIB-i;
 - 2.2. T'i respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë;
 - 2.3. Tu kushtojnë vëmendje të duhur studimeve të tyre dhe të marrin pjesë në aktivitetet akademike;
 - 2.4. Të vijojnë ligjëratat dhe ushtrimet në pajtim me rregullat e programit specifik të studimeve;
 - 2.5. Studentët të cilët nuk i kanë kryer ushtrimet e parapara me syllabus nuk iu lejohet hyrja në provime. Studentëve të tillë iu lejohet kryerja e ushtrimeve në vitin e ardhshëm akademik, në semestrin kur dëgjohet lënda;
 - 2.6. Të sillen mirë si në lokalet e Universitetit, ashtu edhe jashtë tyre për të respektuar dhe ruajtur integritetin akademik të Universitetit;
 - 2.7. Të respektojnë rregullat e kodit etik;
 - 2.8. Të paguajnë pagesa dhe tarifa që janë të caktuara.

Neni 19

1. Këshilli i Fakultetit i përjashton nga Fakulteti dhe Universiteti përgjithmonë ose përkohësisht studentët që i shkelin rregullat e përcaktuara.
2. Përcaktimi i përgjegjësisë disiplinore të studentëve më për së afërmi rregullohet me Rregulloren për Procedurën Disiplinore të UMIB-it.

Neni 20

1. Studentët kanë të drejtë të ankohen kundër vendimit të marrë prej organeve të Universitetit, të njësisë akademike që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet e tyre.
2. Ankesat e tilla i dorëzohen komisionit të studimeve të njësisë akademike brenda 15 ditëve të punës pas shpalljes së vendimit.
3. Komisioni i studimeve është i obliguar t'ia dorëzojë raportin për vendimin e marrë këshillit të njësisë akademike brenda 30 ditëve të punës pas pranimit të ankesës.
4. Ankesa rreth vendimit, në shkallë të dytë vendoset nga komisioni i themeluar nga Senati.
5. Studentët kanë të drejtë të kundërshtojnë vendimin e Senatit në gjykatën kompetente.

Kushtet e regjistrimit të vitit

Neni 21

1. Përfundimi me sukses i vitit në pajtim me programin e studimit është parakusht që studentit të regjistrohet në vitin tjetër.
2. Përgjashtimisht, kushti për regjistrimin e viti tjetër akademik mund të arrihet edhe me minus 2 provime të pa dhëna nga viti i paraprak.
3. Studenti i cili nuk ka mundur të përfundojë me sukses vitin duhet sërish të regjistrohet në vitin e njëjtë të studimeve.
4. Numri maksimal i viteve të regjistruara sërish është i barabartë me numrin e viteve të rregullta të studimit përkatës. Lejohet vetëm një ri regjistrim i një viti dhe nuk mund të ri regjistrohet një vit akademik dy here radhazi.

Neni 22

Senati i UMIB-it me vendim të veçantë përcakton kushtet e regjistrimit të vitit vijues të studentëve, për çdo vit akademik.

Ndërrimi i programit – drejtimit të studimeve

Neni 23

1. Studenti mund të bëjë ndërrimin e programit të studimit duke përfunduar mësimin në një program të studimit dhe duke filluar mësimin në një program tjetër të studimit në njësinë e njëjtë apo në njësinë tjetër akademike të universitetit.
2. Ndërrimi i programit të studimit është i mundur në mes programeve të studimit me qëllim të arritjes së nivelit të njëjtë të arsimit në pajtim me dispozitat e këtij Statuti.
3. Gjatë ndërrimit të programit të studimit, studentit i lejohet legalisht të fillojë programin e ri të studimit nëse së paku 50% e provimeve janë dhënë me sukses gjatë programit të vjetër të studimeve dhe që pranohen në programin e ri të studimeve.
4. Sipas pikës 3 studentit i lejohet të regjistrohet në programin e ri të studimeve:
 - 4.1. Më së paku në vitin e dytë të studimeve ose
 - 4.2. Më së miri në vitin e studimeve që vijon pas programit të vjetër të studimeve.
5. Ndërrimi i programit të studimit nuk mund të bëhet nëse studentit duhet sërish të regjistrohet në vitin e parë të studimeve në programin e ri të studimeve në pajtim me pikën 3 dhe 4.
6. Kërkesa për ndërrim të programit mund të bëhet në të njëjtën kohë me periudhën e kërkesës për konkurrim në fakultet dhe më së voni më 15 shtator të vitit kalendarik.

Neni 24

1. Studenti duhet t'ia dorëzojë kërkesën për ndërrimin e programit të studimit komisionit për studime të njësisë akademike ku dëshiron të vazhdojë studimet. Bashkëngjitur me kërkesën duhet të jetë evidenca për plotësimin e suksesshëm të kërkesave bazuar në programin e mëparshëm të studimit.
2. Komisioni i studimeve përcakton detyrimet individuale për ndërrimin e programit të studimit në pajtim me rregullat e caktuara të programit të studimit.
3. Vendimi për ndërrimin e programit të studimit duhet të merret nga këshilli i njësisë akademike me propozimin e komisionit të studimeve.
4. Ankesa kundër vendimit mbi refuzimin e ndërrimit të programit të studimit duhet t'i bëhet këshillit të njësisë akademike nga studentit, brenda 8 ditëve të punës pas publikimit të vendimit.

Neni 25

Gjatë ndërrimit të programit të studimit prej një universiteti tjetër në Universitetin e Mitrovicës, do të vlejnjë rregullat e njëjta si ato gjatë ndërrimit të programit të studimit brenda universitetit.

Viti akademik

Neni 26

1. Universiteti organizon studimet në pajtim me programet ekzistuese të studimit gjatë vitit akademik i cili zgjat 12 muaj. Viti akademik fillon më 1 tetor dhe mbaron më 30 shtator.
2. Periudha aktive e studimeve (ligjëratat, ushtrimet, seminarët, kollokfiomet, etj.) është e ndarë në dy semestra. Semestri dimëror që fillon më 1 tetor dhe mbaron më 15 janar. Semestri veror që fillon më 16 shkurt dhe mbaron më 31 maj.
3. Mësimi në studimet master zhvillohet në 15 javë për një semestër.

Organizmi i provimeve

Neni 27

1. Për përcaktimin e suksesit akademik do të aplikohen këto metoda:
 - 1.1. Provimi;
 - 1.2. Kollokfiomi;
 - 1.3. Punim seminari;
 - 1.4. Praktika profesionale;
 - 1.5. Testi praktik gjatë ushtrimeve.

2. Studentët janë të obliguar dhe kanë të drejtë të japin provime. Provimet jepen nga të gjitha lëndët, pas përfundimit të mësimit të paraparë me programin mësimor të lëndës. Studenti fiton të drejtën t'i nënshtrohet provimit nga një lëndë pasi t'i shlyej detyrimet që lidhen me atë lëndë, të parashikuara për shlyerje në planin mësimor.

Neni 28

1. Provimet shërbejnë si mënyrë e rregullt e vlerësimit të dijes.
2. Provimet mund të organizohen veç e veç për çdo lëndë ose të kombinohen për më shumë lëndë në pajtim me programin e studimeve (provim me komision).
3. Provimet janë publike dhe mbahen në këto mënyra:
 - 3.1. Me shkrim;
 - 3.2. Me gojë;
 - 3.3. Me shkrim dhe me gojë;
 - 3.4. Praktikë.
4. Provimet e kombinuara me gojë dhe me shkrim bëhen brenda shtatë ditëve.
5. Provimet vlerësohen nga një pyetës ose nga një komision për provime.
6. Provimet mund të mbahen nga një komision për provime nëse:
 - 6.1. Studenti është ankuar;
 - 6.2. Është caktuar me programin e studimeve.
7. Procedura e mbajtjes së provimit është e përcaktuar me programin e studimit.
8. Mënyra e përcaktimit të dijes dhe të dhënies së provimit do të përcaktohet me programin mësimor të lëndës – syllabus.
9. Në momentin e aprovimit të syllabusit nga komisioni për studime i fakultetit, ai bëhet i obligueshëm për realizim.

Afatet e provimit

Neni 29

1. Provimet për studimet master mbahen gjatë afatit të provimeve.
2. Afatet e rregullta të provimeve janë: afati i janarit, qershorit dhe shtatorit.
3. Oraret e afateve të provimeve shpallen në fillim të vitit akademik dhe ato përcaktohen në atë mënyrë që studenti të mos ketë më shumë se një provim në ditë.
4. Oraret e provimeve pasi të jenë shpallur, janë detyruese si për pyetësin ashtu edhe për studentin.

Neni 30

1. Koha e paraqitjes së provimeve do të fillojë jo më herët se 6 javë para përfundimit dhe jo më vonë se 8 ditë para fillimit të afatit të provimit.
2. Orari i provimit duhet të shpallet jo më vonë se tri ditë para datës së provimit.
3. Në të gjitha rastet kur studenti mungon ose tërhiqet nga provimi, provimi konsiderohet që ka dështuar.
4. Dekani i Fakultetit, në bazë të kërkesës së studentit, mund t'i lejojë studentit që të hyjë më herët në provim, po qe se merr pjesë në një program ndërkombëtar për shkëmbim të studimeve ose është bërë mësim praktik jashtë vendit gjatë periudhës së caktuar për provim.

Vlerësimi i studentëve

Neni 31

1. Suksesi i studentit në provim shprehet me nota prej 5 (pesë) deri në 10 (dhjetë).
2. Provimet janë publike dhe shpallen në tabelën e shpalljeve dhe në ueb faqen e njësisë akademike përkatëse.
3. Ndalohet hyrja në provim e personave të jashtëm, qofshin dhe anëtarë të personelit universitar ose të fakultetit, me përjashtim të shefit të departamentit të fakultetit, prodekanit për çështje mësimore dhe personave tjerë të autorizuar me shkrim nga Dekani ose Rektori për të kryer kontroll.
4. Përcaktimi i notës përfundimtare të provimit bëhet në këtë mënyrë:

Pikët	Nota	Përshkrimi	ECTS Nota
91 – 100	10	Shkëlqyeshëm	A
81 – 90	9	Shumë mirë	B
71 – 80	8	Mirë	C
61 – 70	7	Kënaqshëm	D
51 – 60	6	Mjaftueshëm	E
0 – 50	5	Dobët	FX/F

5. Studenti konsiderohet se ka kaluar me sukses provimin kur vlerësohet nga nota 6 deri në 10, ndërsa konsiderohet se nuk e ka kaluar provimin nëse është vlerësuar me notën 5.

Neni 32

1. Studenti ka të drejtë t'i parashtrijë ankesë me shkrim dekanit të njësisë akademike kundër notës së marrë. Ankesa duhet të parashtrohet brenda dy ditëve të punës pasi të jenë shpallur rezultatet.
2. Ankesa mund të bëhet për këto arsye:
 - 2.1. Për provimin me shkrim parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me shkrim;
 - 2.2. Për provimin me gojë parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me gojë;
 - 2.3. Për provimin e kombinuar me shkrim dhe me gojë:
 - 2.3.1. Parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me shkrim para hyrjes në provimin me gojë;
 - 2.3.2. Parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me gojë që nënkupton se është pranuar nota nga provimi me shkrim.
3. Pas pranimit me kohë të ankesës, dekani i njësisë akademike formon komisionin e provimit brenda një dite të punës pasi të jetë pranuar ankesa dhe emëron tre anëtarë, por pa pyetësin kundër notës së të cilit është ankuar studentit.
4. Në rast se përsëritet provimi me gojë, vlerësimi nga komisioni bëhet në ditën vijuese të punës pasi të jetë caktuar komisioni.
5. Në rast të ankesës kundër notës në provimin me shkrim, provimi me shkrim do të rishqyrtohet nga komisioni në ditën vijuese të punës pasi të jetë caktuar komisioni.
6. Nuk mund të parashtrohet ankesë kundër vlerësimit të komisionit.
7. Testet nga provimet lidhur me vlerësimin e studentëve ruhen maksimalisht 30 ditë.

Neni 33

1. Studenti ka të drejtë të riprovohet në lëndën të cilën nuk e ka dhënë.
2. Sipas rregullës, studentit ka të drejtë të hyjë më së shumti tri herë në provimin të cilin nuk e ka dhënë.
3. Studentit pasi të ankohet, me një arsyetim të fortë, mund t'i lejohet nga dekani i njësisë akademike që të hyjë në provim për të katërtën herë. Provimi pastaj mund të mbahet para komisionit prej tre anëtarësh të cilët janë të emëruar nga dekani i njësisë akademike.
4. Në rast se sërish regjistrohet viti i njëjtë, nuk merret parasysh numri i mëparshëm i provimeve të dështuara të studentit.
5. Në rast se studentit sërish dështon 4 herë në provim gjatë vitit të përsëritur, ai humb statusin e studentit të rregullt për këtë lloj të studimeve.

6. Studenti mund të rifitojë statusin e studentit në qoftë se paraqitet në një program të ri të studimeve. Vendimi mbi rifitim të statusit të studentit përcakton provimet dhe të tjera që i pranohen studentit dhe detyrimet e studentit në programin e ri të studimeve.

Përfundimi i studimeve

Neni 34

1. Pas përfundimit të semestrit të fundit të rregullt të studimeve master, studentit do t'i caktohet një periudhë prej 12 muajve për t'i përfunduar provimet (periudha e diplomimit).
2. Studenti mund të kërkojë një herë nga dekani i njësisë akademike për vazhdimin e periudhës së diplomimit edhe për 12 muaj të tjerë.

Neni 35

1. Programet e studimeve master përfundojnë me punimin e tezës për master në pajtim me programet e studimeve.
2. Punimi për master punohet individualisht nga studenti, duke vërtetuar se aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimit mund të aplikohen me sukses për zgjidhjen e problemeve komplekse kërkimore në fushat e caktuara shkencore.
3. Punimi i diplomës për master mund të elaborohet nga dy ose tre studentë (grupi kërkimor), dhe aty duhet të shënohet qartë kontributi i secilit kandidat.
4. Aplikimi për elaborimin e punimit të diplomës për master nga dy ose tre studentë vendoset nga këshilli i njësisë akademike.

Neni 36

Procedura për paraqitje, elaborim, mbrojtje dhe vlerësim të punimit të diplomës për master përcaktohet nga këshilli i njësisë akademike.

Neni 37

1. Studenti që i jep të gjitha provimet e parapara me planin mësimor dhe i kryen obligimet tjera të parapara me akte normative të UMIB-it dhe fakultetit përkatës, si dhe e mbron me sukses punimin e diplomës për master, fiton gradën master i shkencës ose master profesional në lëmin përkatës.
2. Diplomën për kryerjen e studimeve master e nënshkruan Dekani i Fakultetit dhe Rektori i Universitetit.
3. Përmbajtjen dhe formën e diplomës e përcakton Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

Neni 38

1. Diploma studentit i dorëzohet në mënyrë solemne. Promovimi i studentëve të diplomuar bëhet sipas rregullave të cilat i përcakton UMIB-i në bashkëpunim me dekanët e fakulteteve.
2. Universiteti dhe fakultet mbajnë evidencën e studentëve të diplomuar.

Dispozitat kalimtare

Neni 39

1. Kjo Rregullore hynë në fuqi nga dita e miratimit nga Senati i Universitetit të Mitrovicës.
2. Për të gjitha çështjet tjera të cilat nuk janë përfshirë në këtë Rregullore do të zbatohen dispozitat e Statutit të Përkohshëm të UMIB-it dhe Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës.
3. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen në mënyrën në të cilën është miratuar rregullorja.
4. Në pajtim me këtë rregullore, njësitë akademike bëjnë harmonizimin e rregulloreve aktuale për studimet master ku do të pasqyrohen specifikat e secilës njësi akademike.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor